

V E N D I M
Nr. 509, datë 21.9.2000

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.439, DATË 9.9.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSAT E KONVIKTEVE, PËR BURSAT E SHTETIT DHE PËR PAGESAT E FAMILJEVE PËR NXËNËSIT DHE STUDENTËT DHE PËR FËMIJËT QË PRANOHEN NË SHITËPITË E FËMIJËS, NË INSTITUTIN E FËMIJËVE QË NUK DËGJOJNË DHE NUK SHIKOJNË DHE NË INSTITUTIN ME PRAPAMBETJE TË LEHTË MENDORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.8554, dsatë 10.12.1999, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2000", të nenit 32, të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe të nenit 63, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995, "Për sistemin arsimor, parauniversitar", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.439, datë 9.9.1999, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet si vijon:

"Me propozimin e këshillave të komunave apo bashkive, këshilli i qarkut, (përjashtimisht për vitin 2000 prefekti), ka të drejtë të miratojë bursë ose gjysmëbursë, jashtë kriterit ekonomik, brenda planit të vitit të parë, si më poshtë:

- Rrethet deri në 3 bursa.

- Bashkia e Tiranës deri në 30 bursa".

2. Pika 12 ndryshon si vijon:

"Ministritë së Arsimit dhe Shkencës, për vitin shkollor 2000-2001, i jepen 1000 bursa, për arsimin e lartë dhe 900 bursa, për arsimin e mesëm.".

3. Pika 13 ndryshon si vijon:

"Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitet e dyta e sipër, për të gjitha kategoritë e shkollave, është data 30 tetor 2000".

4. Pika 14 ndryshon si vijon:

"Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitet e para, për të gjitha kategoritë e shkollave, është data 15 dhjetor 2000".

5. Pas paragrafit të parë të pikës 14, shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje:

"Personat përgjegjës ngarkohen të zhdëmtojnë shumat e marra padrejtësisht, me propozimin e organit të kontrollit dhe me miratimin e titullarit të institucionit qendror".

6. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe shkencës për zbatimin e këtij vendimi,

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta